



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 273/19
295 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi –Referues, z. Blerim Dina–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “DWH Kosova” SH.P.K. – Prishtinë dhe OE “Ageo & Co” SH.P.K., –Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Geo TECH” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi”, me numër të prokurimit: 635-19-1164-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Pejë, më datën 03.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorit ekonomik “DWH Kosova” SH.P.K. – Prishtinë dhe ankesa e operatorit ekonomik “Ageo&Co” SH.P.K., – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi”, me numër të prokurimit: 635-19-1164-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Pejë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi”, me numër të prokurimit: 635-19-1164-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Pejë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “DWH Kosova” SH.P.K. –Prishtinë dhe ankesa e operatorit ekonomik “Ageo&Co” SH.P.K., – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:13.03.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt:08.04.2019

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dt: 24.05.2019

Njoftimi për tenderues të eliminuar për të dy OE-të dt: 24.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim nga OE“Ageo&CO” dt:25.05.2019.

Kërkesa për rishqyrtim nga OE”DWH Kosova” dt: 29.05.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 31.05.2019 ka marrë vendim që të refuzohen kërkesat për rishqyrtim si të pa bazuara nga OE:“DWH Kosova”SH.P.K. –Prishtinë dhe “Ageo&Co” SH.P.K., – Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues “DWH Kosova” SH.P.K. –Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019 me nr. 273/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi”, me numër të prokurimit: 635-19-1164-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Pejë, duke pretenduar se janë shkelur këto dispozita të LPP-së.

- Shkellje e nenit 1, 6, 7 të LPP-së
- si dhe Shkelje e nenit A01 RRUOPP.

Operatori ekonomik ankues OE “Ageo&Co” SH.P.K., – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.06.2019 me nr. 295/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi”, me numër të prokurimit: 635-19-1164-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Pejë, duke pretenduar se janë shkelur këto dispozita të LPP-së:

- Shkelje të nenit 1, 6, 7, 59, 60, dhe 72 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:21.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Sqarim Hyrës:

OE. “DWH Kosova” SH.P.K, me datë 24.05.2019 e ka pranuar njoftimin për eliminimin ndërsa me datë 29.05.2019 e parashtron Kërkesën për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues, mirëpo Kërkesa e tij e pa bazuar për arsye se Autoriteti Kontraktues konsideron se nuk është parashtruar në afatin e përcaktuar kohor pasi që sipas rregullave dita e fundit për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim ka qenë data 28.05.2019 pasi që data 24.05.2019 ka qenë ditë e premtë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “DWH Kosova”SH.P.K. –Prishtinë:

Eksperti Shqyrtues ka analizuar pretendimet ankimore dhe në bazë të vlerësimeve dhe analizave të bëra vlerëson se Autoriteti Kontraktues Operatorin Ekonomik ankues e ka trajtuar në mënyrë të barabartë me të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në tender.

Arsyeja e refuzimit të kërkesës për Rishqyrtim është e drejtë me vet faktin se afati i rregullt kohor për parashtrimin ka qenë data 28.05.2019 pasi që njoftimi për eliminim OE e ka pranuar me datë 24.05.2019 që ka qenë ditë e premtë, dhe sipas rregullave afati kohor për përlllogaritje ka filluar ditën e njoftimit për eliminimin.

Arsyet e eliminimit nga Autoriteti Kontraktues për OE “DWH Kosova”SH.P.K. kanë qenë shumë konkrete, madje në pretendime ankimore nuk mohohen arsyet e eliminimit lidhur me specifikimet teknike.

- Ne specifikim teknik është kërkuar që numri i kanaleve të jete 450 ndërsa sipas ofertës pajisja ka 432 kanale.
- Memoria e brendshme është kërkuar të jete 30 GB ndërsa OE ankues ka ofruar memorie 8 GB,
- Nuk ofron sqarime lidhur me mundësinë e ngarkim/shkarkim të të dhënave,
- Nuk ofron të dhëna për matje të pjerrtësisë etj.

Sipas vlerësimeve të ekspertit vlerësimi lidhur me OE “DWH Kosova”SH.P.K. nga Autoriteti Kontraktues ka qenë në përputhje me rregullat e LPP-së

Gjithashtu Eksperti Shqyrtues konsideron se eliminimi i OE “Ageo&CO”SH.P.K. ka qenë i drejtë nga ana e Autoritetit Kontraktues për arsye se OE në fjale nuk ofron deklaratë se përmbush specifikimet teknike.

Tek kriteret kualifikuese Autoriteti Kontraktues e ka lënë mundësinë që OE përmes deklaratës së nënshkruar dhe të vulosur të zotohen-deklarohen lidhur me përmbushjen e specifikacionit teknik, gjë që nënkupton se mos zotimi përmes deklaratës siç është kërkuar atëherë operatorët ekonomik do të eliminohen.

Në vendimin e kërkesës për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues në mënyrë të qartë e ka theksuar e deklarata OE (e nënshkruar dhe vulosur) e zëvendëson aneksin 1 që ka të bëjë me specifikacionin teknik, pasi që përmes kësaj deklarate OE ofertues merr përsipër obligimin se furnizimi do të kryhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Autoriteti Kontraktues gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit, vlerësimin e ofertave e ka bërë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, dhe bazuar në vlerësimin e Autoritetit Kontraktues Eksperti Shqyrtues e konsideron të drejtë vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminim të OE ankues.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues vlerëson se ankesat e OE-ve ankuese janë të pa bazuara dhe me këtë rast i rekomandon Panelit Shqyrtues që vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi, për faktin se pretendimet ankimore nuk konsiderohen të bazuara nga ana e Eksperti Shqyrtues.

Operatori ekonomik “DWH Kosova”SH.P.K. –Prishtinë”, përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës:03.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ndërsa përfaqësuesit e të dy OE-ve ankuese nuk ishin prezent në seancë edhe pse te njëjtit nuk kanë kërkuar shtyrjen e seancës dhe nuk kanë dhënë ndonjë arsye për mosardhje në këtë seancë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Berisha deklaroj: Pasi nuk kanë ardhur përfaqësuesit e OE-ve, nuk do të lëshohem në elaburimin e lëndës me shumë, pasi që pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues i cili e ka kryer këtë ekspertizë në mënyrë profesionale dhe shumë të drejtë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Sheqiri deklaroj:Qëndroj prapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkojmë që të hedhen poshtë ankesat e OE-ve ankuese si të pa bazuara dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe të respektohet mendimi i ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE. "DWH Kosova" SH.P.K, me datë 24.05.2019 e ka pranuar njoftimin për eliminimin ndërsa me datë 29.05.2019, e parashton Kërkesën për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues, mirëpo Kërkesa e tij refuzohet si e pa bazuar për arsye se Autoriteti Kontraktues konsideron se nuk është parashtruar në afatin e përcaktuar kohor pasi që sipas rregullave dita e fundit për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim ka qenë data 28.05.2019 pasi që data 24.05.2019 ka qenë ditë e premtë.

Paneli shqyrtues konform eksperti Shqyrtues konstaton se janë analizuar pretendimet ankimore dhe në bazë të vlerësimeve dhe analizave të bëra vlerësojmë se autoriteti kontraktues, operatorin ekonomik

ankues "DWH Kosova"SH.P.K. Prishtinë e ka trajtuar në mënyrë të barabarte me të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në tender.

Arsyeja e refuzimit të kërkesës për Rishqyrtim është e drejtë me vet faktin se afati i rregullt kohor për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të AK-së, ka qenë data 28.05.2019 pasi që njoftimi për eliminim OE e ka pranuar me datë 24.05.2019 që ka qenë ditë e premte, dhe sipas rregullave afati kohor për përlogaritje ka filluar ditën e njoftimit për eliminimin.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se arsyet e eliminimit nga Autoriteti Kontraktues për OE "DWH Kosova"SH.P.K. kanë qenë shumë konkrete, madje në pretendime ankimore nuk mohohen arsyet e eliminimit lidhur me specifikimet teknike.

- Në specifikim teknik është kërkuar që numri i kanaleve të jete 450 ndërsa sipas ofertës pajisja ka 432 kanale.
- Memoria e brendshme është kërkuar të jete 30 GB ndërsa OE ankues ka ofruar memorie 8 GB,
- Nuk ofron sqarime lidhur me mundësinë e ngarkim/shkarkim të të dhënave,
- Nuk ofron të dhëna për matje të pjerrtësisë etj.

Andaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se vlerësimi lidhur me OE "DWH Kosova" SH.P.K. nga Autoriteti Kontraktues ka qenë në përputhje me rregullat e LPP-së.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE "Ageo&CO"SH.P.K., dhe konstaton se arsyeja e eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së, ka qenë e drejtë për arsye se OE në fjalë nuk ofron deklaratë se përmbush specifikimet teknike.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se tek kriteret kualifikuese Autoriteti Kontraktues e ka lënë mundësinë që OE përmes deklaratës së nënshkruar dhe të vulosur të zotohen-deklarohen lidhur me përmbushjen e specifikacionit teknik, gjë që nënkupton se mos zotimi përmes deklaratës siç është kërkuar atëherë operatorët ekonomik do të eliminohen.

Në vendimin e kërkesës për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues në mënyrë të qartë e ka theksuar se deklarata OE (e nënshkruar dhe vulosur) e zëvendëson aneksin 1 që ka të bëjë me specifikacionin teknik, pasi që përmes kësaj deklarate OE ofertues merr përsipër obligimin se furnizimi do të kryhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Pejë– Pejë,
- 1x1 OE –“DWH Kosova”SK.P.K. – Prishtinë
- 1x1 OE–“Areo&CO” SH.P.K., – Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.